



Pranuar / Dostiguar Prenje / Pristato Received / Delivered	27-03-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojka Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	3028/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.390/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.390/2023, të datës 22.02.2023 të ankuesit \_\_\_\_\_, me adrese banimi: Fshati Oshlan, Komuna e Vushtrrisë, kundër Njoftimit Nr.7225/23 të datës 13.02.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.03.2023, mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.390/2023 e datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_, i cila sipas shkresave të lëndës ishte kandidatë në procedurën e rekrutimit "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" të shpallur nga Komuna e Vushtrrisë, me datë 21.02.2023 nëpërmjet adresës zyrtare elektronike [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 22.03.2023 dhe është protokolluar me numër 1969/2022, kundër Njoftimit Nr.7225/23 të datës 13.02.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, lidhur me shpalljen rezultateve përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Vushtrrisë. Ndërsa me datë 17.03.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.02.2023 parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Konkursin e datës 25.11.2022; Njoftimi i Njesisë për menaxhimin e Burimeve Njerëzore i datës 23.01.2023; Njoftimi i Njesisë për menaxhimin e Burimeve Njerëzore i datës 18.01.2023; Njoftimit Nr.7225/23 të datës 13.02.2022 lidhur me shpalljen rezultateve përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm; Formularin e regjistrimit të ankesës i datës 21.02.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 06.03.2023; Përgjigja në kërkesë e datës 17.03.2023; kërkesa e datës 15.11.2022 me shifër 13.Nr.382/2022; Njoftimin e datës 25.11.2022; Listën e aplikantëve; Aplikacionin e ankuesit të datës 01.01.2023 me dosjen e bashkangjitur; Vendimin e datës 16.01.2023 të Kryetarit të Komunës për Themelimin e Komisionit të Vlerësimit; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 09.10.2019; Akt emërimit 09.01.2013; Akt emërimit 01.04.2022; Akt emërimit 09.01.2013; Akt emërimit 25.01.2014; Marrëveshjen e datës 05.01.2023 me shifër:02/23; Vendimin Nr.2873/23 e datës 17.01.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës si dhe Njoftimin e datës 08.02.2023 për rezultatet e vlerësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_, është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Vushtrrisë me datë 25.11.2022 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit të pranimit (i jashtëm) për emrin e grupit "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" me numër të Referencës: RN00010499, për një (1) pozita, si vijon: "*Inspektor i Shërbimeve Publike*", ndërsa bazuar në aplikacionin e ankuesit të datës 01.01.2023 konstatohet fakti se ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër të Referencës: RN00010499, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrrisë përmes Vendimit Nr.287/23 të datës 17.01.2023 ia ka refuzuar ankuesit aplikacionin në fazën e verifikimit paraprak, me arsyetimin se i njëjti nuk i plotëson kriteret e konkursit që ndërlidhen më përvojën e punës profesionale.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se Vendimit Nr.2873/23 të datës 17.01.2023 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e ka mbajtur edhe këshillën juridike për ankimim sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 15 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo ankuesi nuk ka ushtruar ankesë të brendshme sikurse përcaktohet me dispozitat e kësaj rregulloreje, mirëpo i njëjti me datë 22.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshill kundër Njoftimit Nr.7225/23 të datës 13.02.2022 lidhur me shpalljen rezultateve përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, me pretendimin ankimor se Komuna e Vushtrrisë me rastin e shpalljes së konkursit të datës 25.11.2022 për pozitën "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" ka aplikuar gabimisht dispozitat e ligjit material dhe Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që ka ndryshuar kriteret lidhur me përvojën e punës profesionale sikurse përcaktohet prej dy (2) vitesh, duke i rritur këtë kriter në tre (3) vite përvojë pune profesionale sipas konkursit, duke ia pamundësuar kështu të njëjtit pjesëmarrjen në këtë procedurë të konkurrimit qysh në fazën e verifikimit paraprak.



Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative Kolagji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 15 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktohet se: *"5. Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katermbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj",* prandaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore është përcaktuar se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi që ka shpall procedurën e pranimit, sikurse përcaktohet në paragrafin 4 i nenit 31 të së njëjtës rregullore: *"Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurrimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.1. kandidati i pakënaqur me rezultatet e verifikimit paraprak ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15 të kësaj rregulloreje; 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, apo 4.3. kandidati është cenuar drejtpërdrejtë nga aktet me të cilat është zgjidhur ankesa e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15, sipas paragrafit 6 të nenit".*

Prandaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji i Këshillit nga vlerësimi i provave lidhur me këtë procedurë të pranimit ka konstatuar se përkundër faktit se me Vendimin Nr.2873/23 të datës 17.01.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrisë i është dhënë këshilla juridike se pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda tri (3) ditësh në Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore lidhur me refuzimin e aplikacionit, ndërsa me asnjë provë ankuesi nuk ka mundur të dëshmojë se i njëjti të këtë parashtruar ankesë të brendshme, atëherë në vështrim të bazës ligjore si me lartë ankuesi duhej të ushtronte fillimisht ankesë pranë Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ashtu siç është përcaktuar me nenin 15 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: *.... Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj",* kështu që pas konstatimit se ankuesi ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa shteruar procedurën e ankesës së brendshme sikurse përcaktohet me paragrafin 4 të nenit 31 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se ankesa A.nr.390/2023 e datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme në rastin konkret, rrjedhimisht e njëjta është hedhur poshtë si e palejuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që në rastin ankuesi fillimisht nuk i ka ndjekur procedurat ankimore sikurse përcaktohet shprehimisht me dispozitat e ligji material dhe akteve që rrjedhin prej tij.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.390/2023

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit .
- Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

